

LIGJ
Nr. 39/2014

**PËR FALJEN E DËNIMEVE ADMINISTRATIVE NË FORMËN E GJOBAVE, TË VËNA NË BAZË
TË KONTROLLEVE DHE VERIFIKIMEVE TATIMORE, TË KRYERA PËR PERIUdhËN
1 MARS DERI MË 31 GUSHT 2013**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj parashikon faljen e gjobave të vendosura, si pjesë e detyrimit tatimor, nga administratat tatimore, qendrore dhe vendore, ndaj tatimpaguesve, të evidentuara dhe të kontabilizuara në regjistrat tatimorë për periudhën 1 mars deri më 31 gusht 2013.

Neni 2
Tatimpaguesit përfitues

Përfitojnë nga ky ligj të gjithë tatimpaguesit, persona fizikë dhe juridikë, të regjistruar në administratat tatimore, qendrore dhe vendore, dhe që janë debitorë për detyrimet tatimore të përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji.

Neni 3
Falja e gjobave

1. Falen gjobat e vendosura si pjesë e detyrimit tatimor, që janë të evidentuara sipas datës së nxjerrjes së njoftim-vlerësimit (akti administrativ) ose të kontabilizuara në regjistrat e administratave tatimore, qendrore dhe vendore, gjatë periudhës 1 mars deri më 31 gusht 2013, ndaj tatimpaguesve, persona juridikë apo persona fizikë, të regjistruar në administratat tatimore.

2. Falen gjobat e vendosura, që janë evidentuar sipas pikës 1, të këtij neni, të cilat, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë ankimuar dhe janë në proces ankimi administrativ apo në proces gjyqësor.

3. Të gjithë tatimpaguesit që janë dënuar me gjobë administrative për punonjës të padekluar apo të deklaruar me vonësë, për mosinstalim të pajisjeve fiskale apo moslëshim të kuponit tatimor ose moslëshim të biletave, u falen shumat e gjobave të vendosura.

Neni 4
Përjashtimet nga falja

1. Përjashtohen nga falja e çdo dënimi administrativ (gjobës), të përcaktuar sipas nenit 3 të këtij ligji, masa e tatimit dhe kamatëvonesat.

2. Përjashtohen nga falja gjobat e parashikuara në nenin 3, të këtij ligji, të cilat janë të llogaritura dhe të regjistruara automatikisht nga sistemi informatik i tatimeve, për shkak të shkeljeve të dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 5
Rimbursimi i gjobave të paguara

1. Subjekteve që kanë bërë pagesat e gjobave, të përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, u rimbursohen në masën 100 për qind shumat e paguara të gjobave, sipas radhës së datës së pagesës së bërë.

2. Ministri i Financave nxjerr udhëzimin për zbatimin e këtij neni.

Neni 6

**Procedura e shuarjes së detyrimeve të falura
nga ky ligj**

Brenda 5 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, administratat tatimore, qendrore dhe vendore, fshijnë dënimet administrative, të falura sipas këtij ligji, dhe bëjnë pasqyrimet konkrete të fshirjes në regjistrat e tyre.

Lista e subjekteve përfituese dhe vlera e gjobave përkatëse publikohen brenda 5 muajve në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave.

Neni 7

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes që, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për përcaktimin e kompetencave konkrete të administratave tatimore, qendrore dhe vendore, për evidentimin e praktikave të tatimpaguesve që përfitojnë nga ky ligj, si dhe procedurat, dokumentacionin e rregullat për mënyrën e evidentimit të debitorëve që përfitojnë nga kjo falje dhe shuarjen e gjobave.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 17.4.2014

Shpallur me dekretin nr. 8558, datë 12.5.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani